

## **Ndryshimet në Statut sipas Vendimit të Gjykatës Nr. 1590/9 datë 13.12.2010**

### Neni 3

Pika 5 ishte “te mbikëqyrë zbatimin e standardeve kontabël nga anëtarët e saj, te kodit te sjelljes dhe te disiplinës profesionale” behet “te mbikëqyrë zbatimin nga anëtarët e saj te rregullimeve ligjore ne fushën e profesionit te kontabilistit, te rregullimeve dhe standardeve kombëtare e ndërkombëtare ne fushën e kontabilitetit, te auditimit, te legjislacionit tatimor me qellim për te përmirësuar raportimin financiar, transparencën ndaj publikut dhe kërkesat e Kodit te Etikes”.

### Neni 7

Shtohet ne listën e Organeve te Drejtimit “Komiteti i Kontrollit te Cilësisë”.

### Neni 10

Ndryshohet fjalia “Ajo zgjedh dhe revokon anëtarët e Këshillit te Drejtimit, te Kontrollit te Brendshëm, dëgjon raportet e tyre, cakton kuotat e anëtarësisë, vendos për buxhetin dhe llogarite, organogramen dhe çdo rregullim tjetër lidhur me organizimin profesional te parashikuar ne këtë Statut” ne “Ajo zgjedh dhe revokon anëtarët e Këshillit te Drejtimit, te Kontrollit te Brendshëm, te Komitetit te Kontrollit te Cilësisë, dëgjon raportet e tyre, cakton kuotat e anëtarësisë, vendos për buxhetin dhe llogarite, organogramen dhe çdo rregullim tjetër lidhur me organizimin profesional te parashikuar ne këtë Statut.

### Neni 17

Ndryshohet paragrafi i mëposhtëm:

“Anëtarët e Këshillit te Drejtimit zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme me një mandat prej katër vjetësh dhe jo me tepër se tre mandate radhazi.

Mbasi te jete bere zgjedhja e presidentit dhe zëvendësit te tij, te cilët kane mandat 4 vjeçar, anëtarët e tjerë renditen sipas numrit me te madh te votave dhe tre te paret kane mandat katër vjeçar, ndërsa dy te tjerët kane mandat dy vjeçar.”

ne:

“Anëtarët e Këshillit te Drejtimit, përveç një anëtari qe vjen automatikisht nga dega e IKM e Tiranës, zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme.

Presidenti dhe zëvendësit e tij, zgjidhen për një mandat 4 vjeçar me te drejte zgjedhje vetëm njëherë.

Anëtarët e tjerë te Këshillit te Drejtimit zgjidhen për një mandat 4 vjeçar, me te drejte rizgjedhje vetëm pas kalimit te një mandati nga përfundimi i mandatit si i zgjedhur.”

Ne paragrafi 2 pika 3 shtohet fjalia “Përfundohet nga ky kufizim kryetari i degës Tirane, i cili pasi është zgjedhur nga anëtarësia e degës Tirane, është automatikisht anëtar i Këshillit te Drejtimit te IKM.

Shtohet Neni 24/1

Komiteti i Kontrollit te Cilësisë

Komiteti i Kontrollit te Cilësisë ka për detyre te verifikojë dhe kontrollojë cilësinë e shërbimeve te ofruara nga Kontabilistet e Miratuar, ne përputhje me ligjin Nr. 10091 date 05.03.2009, “Për Auditimin Ligjor Organizimin e Profesionit te Ekspertit Kontabël te Regjistruar dhe te Kontabilistit te Miratuar” standardet kombëtare dhe ndërkombëtare te kontabilitetit, legjislacionin tatimor, rregullat e tjera qe lidhen me profesionin si dhe Kodin e Etikes Profesionale.

Shtohet Neni 24/2

Komiteti i Kontrollit te Cilësisë përbëhet nga 3 Kontabiliste te Miratuar, anëtarë te shoqatës. Komiteti zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhe 2 vjeçare po jo me shume se 2 mandate.

Asambleja e Përgjithshme pas zgjedhjes se anëtarëve te Komitetit te Kontrollit te Cilësisë, cakton si kryetar te Komitetit te Kontrollit te Cilësisë anëtarin qe ka fituar numrin me te madh te votave dhe ne rast votash te barabarta Anëtarin me te moshuar.

Komiteti i Kontrollit te Cilësisë vepron ne baze te Rregullores te miratuar nga Këshilli i Drejtimit te shoqatës.